Fachstelle für Familienfragen

VDEKJA

- çfarë duhet bërë në rast të vdekjes'
- Entit për varrim / gjendjes civile duhet t'i dorëzohen
- Për shpallje / lajmërim pran Entit për varrim / Gjendjes civile janë të obliguar
- Pyetjet e Entit për varrim / Gjendjes civile
- Udhëzimet e Entit për varrim / gjendjes civile
- Punët për t'u kryer pas bisedës paraprake me Entin për varrim / Gjendjen civile
- Afatet, orari i punë dhe qendra e punës
- Vdekja e papritur e foshnjës
- Shoqërimi në vdekje dhe eutanazia
- Mjekësia paliative (lehtësuese)

Vdekja konfronton me përfundimin e jetës dhe vdekjen e vetvetës. Kjo shkakton frikë. Shumë njerëz merren me vdekjën së pari nën presionin e një rasti të vdekjës. Atëherë është koha shumë e shkurtë! Ata që mbesin prapa shpesh janë si të mpirë nga dhimja, mërzia. Megjithatë, ata duhen të veprojnë, të marrin vendime të rëndsishme.

ÇFARË DUHET BËRË NË RAST TË VDEKJES?

Varësisht nga komuna duhet të lajmërohen Enti për varrim ose Gjendja civile. Autoriteti kompetent pastaj bën lajmërimin e të gjitha autoriteteve tjera dhe ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me procedurën e varrimit. Varrimi mund të bëhet më së hershmi 48 orë pas vdekjes.

Duhet të merren në konsideratë dëshirat apo udhëzimet e mundshme, të cilat i ka lënë në amanet personi i vdekur. Në rast të mungesës së një deklarate të tillë të vullnetit apo dëshirës, duhet të merren në konsideratë dëshirat e anëtarëve të ngushtë të familjes. Marrëveshjet apo dëshirat rreth varrimit mund të depozitohen pranë Entit për varrim edhe gjatë kohës sa personi është ende gjallë.

Në vijim do të paraqesim në pika të shkurtëra se cilat obligime duhet të kryhen rradhazi pranë Entit për varrim/Gjendja civile:

Vdekja në shtëpi
Së pari duhet të lajmëroni mjekun. Ai duhet të bëj konstatimin e vdekjes dhe të lëshoj vërtetimin mjekësor për vdekjen. Vetëm atëherë mund të dorëzohet personi i vdekur në morg.

Vdekja në spital, në klinikën paliative (Hospiz) ose në shtëpinë e pleqëve
Personi kujdestar e lajmëron mjekun dhe merret me veshjen dhe rregullimin e personit të vdekur. Sipas rregullit spitali, klinika paliative apo shtëpia e pleqëve i dërgon Gjendjes civile kompentente vërtetimin mjekësor të vdekjes së bashku me një nekrologji (lajmërim i vdekjes) me shkrim. Edhe anëtarit të familjes i dorëzohet nekrologjia e spitalit, e klinikës paliative, shtëpisë së pleqve ose vërtetimi mjekësor i vdekjes.

Në rast të një aksidenti, vetëvrasjeje ose ndihmës së shoqëruar për vdekje duhet të përfshihet edhe policia.

FAQET / ADRESAT
- **www.bl.ch** > Sicherheit > Zivilrecht > Todesfälle > Was tun, wenn jemand stirbt?
- Portal zum Trauerfall: **www.trauerfall.ch**

Entit për varrim / Gjendja civile duhet të i dorëzohen

- Vërtetimi mjekësor i vdekjes, respektivisht nekrologjinë e spitalit, klinikën paliative (Hospiz), shtëpisë së pleqëve
- Libri familjar
- Vërtetimi i paraqitjes (në rast se personi i vdekur është shtetas i huaj duhet të dorëzohet edhe letërnjoftimi për të huaj ose pasaporta).

Për shpallje / lajmërim pranë Entit për varrim / Gjendje civile janë të obliguar

- bashkëshorti/ja ose
- fëmijet dhe bashkëshortët e tyre ose
- personat e afërt familjar të të vdekurit që jetojnë në po të njëjtin vend ose
- personi i pranishëm me rastin e vdekjes ose
- Administrata e spitalit, klinika paliative (Hospiz), shtëpisë së pleqëve.

Pyetjet e Entit për varrim / Gjendjës civile

- A do të varroset personi i vdekur në tokë apo të kremohet?
- A dëshirohet një cermoni varrimi në kishezën e varrezave, në kishë, apo vetëm një liturgji pranë varrit ose një ritual i organizuar privatisht?
- A do të varroset personi i vdekur në një varr serik, me urnë, varr të përbashkët apo varr familjar? (Nëse dëshirohet varrimi në një varr të përbashkët, rekomandohet që gjatë kohës sa personi të jetë gjallë të dorëzohet një deklaratë përkatëse pranë Entit për varrim.)
- Kush do t'i përfaqësoj trashëgimtarët (adresat kontaktuese për komunën, autoritetin e qytetit)?
- A do të publikohet shpallja private e vdekjes menjëherë apo pas varrimit?
- A duhet të mbetet vetëm me shpalljen zyrtare të vdekjes?
- Kur mund të bëhet futja në arkivol, respektivisht transferimi (në rast të vdekjes në shtëpi)?

Udhëzimet e Entit për varrim / Gjendjes civile

- Autoriteti kompetent udhëzon futjen në arkivol, transportin e kufomës, krematimin dhe/ose vendosjen e kufomës në ndërtesën e varrezave si dhe transportin e urnës.
- Cakton terminin e detyrueshëm për varrimin dhe
- U cakton anëtarëve priftin përgjegjës.
- Njofton priftin, kopshtarin e varrezave, kisharin ose organizatorin.

Bën shpalljen zyrtare të vdekjes në gazetat përgjegjëse vendase (sipas dëshirës kjo mund te bëhët edhe më vonë).

Këto udhëzime mund të variojnë sipas komunave.

Punët për t`u kryer pas bisedës paraprake me Entin për varrim/ Gjendjen civile

- Sa më parë të vihet kontakti me priftin përgjegjës
- Të jepen udhëzime për shtypjen e njoftimeve për vdekjen dhe të bëhet përpilimi i adresave se ku do të dërgohen ato
- Të jepen udhëzimine për shpalljet e vdekjes për gazeta
- Sipas rastit të bëhet porosia e drekës së vdekjes
- Të lajmërohen familjarët, miqtë, shoqatat, punëdhënësi i personit të vdekur
- Të lajmërohen sigurimet shëndetësore dhe arka pensionale/ e pleqërisë AHV
- Të dorëzohet testamenti: Nëse ka lënë personi i vdekur testament, obligohet poseduesi/ja i tij

(sipas nenit 556 të Kodit civil) që atë të e dorëzoj menjëherë tek Autoriteti për çeshjte trashëgimore (Gjykatën e qarkut të vendbanimit të fundit të personit të vdekur) i cili pastaj bën hapjen e tij.

Afatet, orari i punës dhe qendra e thirrjeve
Rasti i vdekjes duhet t`i lajmërohet Entit për varrim / Gjendjes civile brenda afatit prej 2 ditësh (kjo sipas nenit 81 të Rregullores së Gjendjes civile). Informohuni për orarin e punës së këtyre institucioneve. Zakonisht Entet për varrim / Gjendja civile gjatë fundjavëve nuk disponojnë me qendër të thirrjeve. Jo rrallë komuna posedon me qendër të thirrjeve gjatë fundjavëve të zgjatura ose festave zyrtare. Informatat i jep Enti për varrim / Gjendja civile e vendbanimit.

Varrimi sipas ritualit islam

Duke ju falenderuar përkrahjes së autoriteteve përkatëse, Komisioni musliman i Baselit mund t'u ofrojn muslimanëve dhe muslimaneve të Baselit dhe Baselland-it prej vitit 1999 varrimin sipas ritualit islam.

Varrezat me varrim islam:

Basel
Hörnli
Baselland
Allschwil, Birsfelden, Pratteln, Liestal, Botmingen, Oberwil dhe Münchenstein.

Autoriteti për çështje trashëgimore
Autoriteti për çështje trashëgimore merret me trashëgiminë e personit të vdekur. Ndër të tjerash ky bën përpilimin e një inventari, bën hapjen/publikimin e çdo testamenti të gjetur, kontratave martesore dhe/ose atyre trashëgimore të cilat ndërlidhen me rastin e vdekjes dhe bën lëshimin e vërtetimit të trashëgimisë. Detajet lidhur me kompetencën e Autoritetit për çeshtje trashëgimore, si dhe informatat e përgjithshme mbi të drejtat dhe detyrimet të trashëgimtarëve mund të merren në këtë faqe/vegëz:

www.bl.ch > Sicherheit > Bezirksschreibereien > Erbschaft > Informationen Erbschaftswesen

Kompetent është Autoriteti për çështje trashëgimore i komunës suaj. Adresat e secilit prej tyre mund të gjenden në:

www.bl.ch > Sicherheit > Bezirksschreibereien > Kontaktstellen

VDEKJA E PAPRITUR E FOSHNJËS

Vdekja e papritur e foshnjës, e quajtur edhe si vdekje e fëmiut apo Sudden Infant Death Syndrome (SIDS) është vdekja e papritur dhe e menjëhershme e një bebe të konsideruar më parë si e shëndetshme. Kjo lloj vdekje konsiderohet si njëra prej vdekjeve më të shpeshta në moshën foshnjore. Ajo shfaqet pa shenja të dukshme gjatë fjetjes dhe i atakon veçanërisht bebet në vitin e parë të jetës së tyre dhe shfaqet tek të gjitha shtresat shoqërore. Deri më tani nuk ka asnjë mënyrë parashikimi për këtë lloj të vdekjes së foshnjës. Mirëpo, disa masa veprimi, të cilat mund t`i gjeni në ueb-faqen e Shoqatës zvicerane të Pediatrisë mund të iu ndihmojnë, të shmangëni një gjë të tillë:

- Mundohuni të evitoni pirjen e duhanit dhe keni kujdes të siguroni ambient pa tym duhani. Kjo vlen si për kohën gjatë shtatëzënësisë, gjatë vitit të parë të lindjes së fëmiut si dhe më tutje. Çdo cigare e ngrit rrezikun e vdekjes së papritut të foshnjës.
- Keni kujdes për temperaturën e dhomës: temperatura ideale e dhomës sillet në mes 17° dhe 19° C. Mbroni shtratin e fëmiut prej rrezeve direkte të diellit dhe mos e leni afër nxemjes/radiatorit.
- Lerëni beben të flej në pozitën me shpinë ose anash. Nuk ekziston asnjë lidhje në mes të fjetjes në pozitën barkas dhe vdekjes së papritur të foshnjës, por prap se prap pozita e të fjeturit barkas mund të ngrit dukshëm rrezikun e vdekjes së papritur të foshnjës. Pa e detyruar bebën Tuaj për pozitën e të fjeturit, Ju vendoseni atë të shtrirë në shpinë. Bebes suaj nuk i nevojitet jastëku. Frika se beba mund të vdes nga të vjellat e veta është e pabazë. Nëse Ju e vendoseni atë në pozitën anash, atëherë dora e poshtme duhet të jetë e vendosur para trupit, në mënyrë qe beba të mos rrotullohet në pozitën barkas. Pozitën e shtrirë barkas beba Juaj mund t`a shijoj sa të jetë në gjendje të zgjuar.
- Mbroni beben Tuaj me rroba adekuate nga ngrohja e tepruar. Sidomos koka duhet të jetë e lirë/e pambuluar, në mënyrë që kjo nxehtësi/temperaturë e tepërt të del jashtë.
- Përshkak të rrezikut nga një kongjestion i nxehtësisë ose të një pengese në frymëmarrje, Ju duhet të shmangeni përdorimin e jastëkut, shtratit me susta, "Nuscheli" (faculeta thithjeje) dhe lëkurave.
- Ushqeni beben Tuaj sa më gjatë me gji. Sipas njohurive të ditëve te sotme, të ushqyerit me gji ka efekte preventive, pasiqë qumshti i nënës ofron një lloj mbrojtje prej alergjive dhe infeksioneve.

Ju duhet të shkoni me beben Tuaj menjëherë të mjeku në rastet si vijojnë
- Beba ka fituar një ngjyrë të kaltërt në fytyrë
- Në gjumë gjatë të fjeturit beba djersitet së tepërmi (kjo do të thotë që rrobat e bebes, në temperaturë dhome janë aq shumë të lagura, saqë duhet të ndërrohen) ose është dukshëm e zbehtë
- Vëreni që beba në gjumë ka pauza/ndërprerje të frymëmarrjes deri në 15 sekonda
- Është shumë vështirë të zgjohet beba nga gjumi
- Beba ka të vjellura të shpeshta, gëlltitet ose ka probleme gjatë pirjes
- Beba ka temperaturë ose refuzon të hajë
- Beba bërtet ose klithë dukshëm dhe nuk mund të qetësohet.

Disa hulumtues përfaqësojnë mendimin, se vdekja e papritur e fëmijës ka për shkaktar kërpudhat, të cilat gjenden në dyshekun e tyre të fjetjes. Mirëpo kjo teori është përgënjështruar. Është diskutabil fakti, se a ofrojnë mbrojtësit e shtrenjtë të dyshekut me të vërtetë mbrojtjen e duhur.

FAQET / ADRESAT

- **www.swiss-paediatrics.org** > Eltern > Vorbeugung
- **www.familienleben.ch** > Trauer > plötzlicher Kindstod

SHOQËRIMI NË VDEKJE DHE EUTANAZIA

Në ditët e sotme ekziston një seri e madhe e literatures mbi të vdekurit dhe vdekjën. Punë pioniere në këtë fushë ka bërë Elisabeth Kübler-Ross. Bisedat emotive të hulumtueses zvicerane mbi vdekjën me personat e sëmurë për vdekje, kanë shpalosur ndjenjat dhe mendimet e thella të personave afër vdekjës dhe kanë vendosur një moment historik në drejtim të një sjellje të pjekur dhe me përgjegjësi të shoqërisë ndaj të vdekurit dhe vdekjes. Elisabeth Kübler-Ross tregon se si njerëzit, duke u ballafaquar me të vdekurit dhe vdekjen, kanë përjetuar një lirim nga frika dhe ndjenjat e fajit dhe kanë arritur të kenë një qëndrim të ri karshi jetës, e cila karakterizohet nga besimi, mirëbesimi dhe dashuria. Ajo rrëfen nga përvoja e saj, e marrë nëpër shumë seminare dhe punëtori (workshop-e) dhe lejon të marrim pjesë në një proces intensiv të shkëmbimit të përvojës dhe ndjenjave.
Në librin e saj të parë novator „Interviews mit Sterbenden“ („Intervista me persona afër vdekjes“), Elisabeth Kübler-Ross emërton pesë fazat e vdekjës: mospranimi, zemërimi, negociimi, depresioni, miratimi/pëlqimi. Gjatë viteve në vijim është konstatuar se këto faza nuk përdoren vetëm gjatë procesit të vdekjes, por edhe gjatë përjetimeve të vështira jetësore dhe katastrofave. Ato ofrojnë njohuri dhe këshilla, të cilat lexuesve u ndihmojnë të normalizojnë jetën e tyre dhe të gjejnë kurajo për të vazhduar atë.
Në Zvicër është e lejuar eutanazia (ndihma për të vdekur). Aktualisht është duke u përgaditur Ligji mbi Eutanazinë, i cili ende përmbanë pika të kontestueshme.

Eutanazinë në Zvicer e ofrojnë shoqata Exit dhe Dignitas. Ato punojnë për të drejtën e njerëzve për vetëvendosje lidhur me vdekjen dhe ofrojnë dispozita për pacientë, ndihmë ligjore dhe kur të iu vjen fundi i jetës, sipas nevojes, një shoqërim të sigurtë dhe të denjë. Për njerëz profesionit dhe të thjeshtë, Kryqi i Kuq ofron kurse dhe edukime avansuese lidhur me temën “Të vdekurit dhe shoqërimi në vdekje“.

FAQET / ADRESAT

- **www.exit.ch**
- **www.dignitas.ch**
- **www.redcross.ch** > Kurse > redcross-edu

LITERATUR

- **Todesfall. Ein Ratgeber für Hinterbliebene**
  Monika Fischer, Paul Haupt Verlag, 2001

Bücher von Elisabeth Kübler-Ross:

- **Jedes Ende ist ein strahlender Beginn.** Für alle Menschen, die Trost und Zuspruch suchen
  Silberschnur-Verlag, 1992
- **Reif werden zum Tode.** Es kommt auf die Intensität des Lebens an,
  Droemer Knaur Verlag, 2004
- **Dem Leben neu vertrauen.** Den Sinn des Trauerns durch fünf Stadien des Verlustes finden, David Kessler (Mitautor),
  Kreuz-Verlag, 2009
- **Interviews mit Sterbenden**,
  Kreuz Verlag, Neuausgabe 2009

MJEKËSIA PALIATIVE (LEHTËSUESE)

Në rajonin e Baselit ekzistojnë dy klinika të Mjekësisë paliative (lehtësuese):
„Hospiz im Park“ në Arlesheim është një klinikë, e cila posedon një udhëzim publik për shërbime të mjeksësisë paliative. Një ekip interdisciplinar trajton, përkujdeset dhe i shoqëron njerëzit, të cilët vuajnë nga sëmundje të pashërueshme dhe që janë në një stad të avansuar. „Hildegard Hospiz“ në Basel është një klinikë speciale për mjekësi paliative, përkujdesje dhe trajtim të pasëm të sëmundjeve akute.

FAQET / ADRESAT

- **Hospiz im Park**
  Stollenrain 12, 4144 Arlesheim, Tel. 061 706 92 22
  www.hospizimpark.ch
- **Hildegard-Hospiz**
  St. Alban-Ring 151, 4020 Basel, Tel. 061 319 75 75
  www.hildegard-hospiz.ch